

Politikëbërja në nivel nacional 2012–2017

Strategjitë: Procesi i draftimit,
roli i Zyrës për Planifikim Strategjik dhe
mënyra e vlerësimit të zbatimit



Politikëbërja në nivel nacional 2012-2017

Strategjitë: Procesi i draftimit,
roli i Zyrës për Planifikim Strategjik dhe
mënyra e vlerësimit të zbatimit



Përgatitur nga: **Roberta Osmani** dhe **Besnik Prekazi**

E drejta e autorit © 2018. Democracy Plus (D+)

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjeti elektronik, mekanik, fotokopjohet apo të tjera, pa lejen e D+.

Përkrahur nga:



Ky projekt u financua përmes grantit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit.

Përmbajtja

Hyrje	6
Metodologjia	9
Vlerësimet Sipas Udhëzimit Administrativ 02/2012	10
Vlerësimet e Zyrës për Planifikim Strategjik	12
Si e monitorojnë Ministrinë zbatimin e Strategjive?	14
Rekomandime	22

Hyrje

Dokumentet strategjike përcaktojnë prioritetet dhe drejtimin për politikat publike që ndiqen nga institucionet bartëse dhe ato të linjës, dhe si të tilla i japin drejtim politikave madhore, prandaj është tejet e rëndësishme që të ndiqen procedurat dhe kriteret për përgatitjen e tyre si dhe të vlerësohet në mënyrë standarde respektimi i këryre rregullave para se këto dokumente të hyjnë në fuqi.

Strategjitë janë dokumente afatgjatë dhe kushtet për realizimin e tyre mund të ndryshojnë përgjatë periudhës që e mbulojnë, prandaj institucionet bartëse duhet t'i vlerësojnë arritjet dhe ngecjet në implementimin e tyre në praktikë në mënyrë sistematike, dhe ta bëjnë të qasshëm këtë vlerësim për të gjitha grupet e interesit dhe publikun.

Qeveria e Kosovës në periudhën 2012–2017 ka miratuar 52 strategji nga Zyra e Kryeministrit dhe 16 ministri. Të gjitha këto strategji janë përpiluar në bazë të Udhëzimit Administrativ (UA) 02/2012 për Procedurat, Kriteret dhe Metodologjinë për Përgatitjen dhe Miratimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve për Zbatim. Numri i strategjive që draftohen dhe hyjnë në fuqi nga institucionet është mjaft i madh, në këtë periudhë pesë vjeçare mesatarisht për një vit janë miratuar 10 strategji.

Procesi i miratimit të një strategjie nga qeveria, e përfshinë Ministrinë e Financave e cila bënë vlerësim të implikimeve buxhetore dhe Zyrën për Planifikim Strategjik (ZPS) në kuadër të Zyrës së

Kryeminsitrit, e cila jep vlerësim për përmbushjen e kriterëve të përcaktuara me UA 02/2012 dhe i propozon qeverisë miratimin e strategjisë. Megjithatë, disa nga strategjitë që kanë kaluar nëpër këto procedura dhe janë miratuar nga qeveria, nuk i plotësojnë të gjitha dispozitat e UA 02/2012.

Sipas nenit 16 të këtij udhëzimi, duhet të bëhet vlerësimi i arritjes së prioritetëve të Qeverisë, përkatësisht vlerësimi i përmbushjes së objektivave dhe aktiviteteve të strategjive në baza të rregullta. Megjithatë një numër i vogël i institucioneve angazhohen rreth kësaj. Po ashtu, në disa opinione të ZPS për strategjitë, përfshihet rekomandimi se për ato strategji të cilave iu mungon Plani i Veprimit duhet të hartohet një i tillë në mënyrë që të iu shërbejë si mekanizëm për matje të implementimit në praktikë. Mirëpo roli i ZPS karshi procesit të mbikëqyrjes së punës së institucioneve për monitorim nuk është qartësuar nga UA dhe si rezultat ZPS nuk është angazhuar në kërkim të llogaridhënies në këtë aspekt. Institucionet që kanë mekanizma për vlerësimin e implementimit të strategjive në praktikë, raportet që prodhohen nga ky monitorim nuk i kanë të qashshme në ueb faqet e tyre (përveç Ministrisë së Financave¹).

Në këtë raport pasqyrohet numri i strategjive të miratuara në një periudhë pesë vjeçare, nga 2012 deri në 2017, respektimi i dispozitave të UA 02/2012 që përcakton procedurat dhe kriteret e përgatitjes së tyre, si dhe nivelin e angazhimit institucional në monitorim dhe vlerësim të tyre.

¹ Ministria e Financave i ka publikuar raportet e monitorimit dhe vlerësimit në ueb faqen e vetë zyrtare.

Grafikoni 1. Numri i dokumenteve strategjike për secilën ministri dhe ZKM në periudhën 2012–2017

Institucioni	Numri i Strategjive	Strategjia
1. Ministria e Punëve të Jashtme	0	
2. Ministria e Infrastrukturës	2	<ul style="list-style-type: none"> - Strategjia Sektoriale e Transportit Multimodal 2015-2025 - Strategjia e Sigurisë Rrugore 2016-2020
3. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	2	<ul style="list-style-type: none"> - Strategjia për Menaxhimin Mbeturinave 2013-2022 - Strategjia për Cilësinë e Ajrit 2013-2022
4. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	1	<ul style="list-style-type: none"> - Strategjia për Vetëqeverisjen Lokale 2016-2026
5. Ministria për Komunitete dhe Kthim	1	<ul style="list-style-type: none"> - Strategjia për Diasporën dhe Mërgatën 2013-2018
6. Ministria e Forcës së Sigurisë	0	
7. Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike	1	<ul style="list-style-type: none"> - Strategjia Kombëtare për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018
8. Ministria e Financave	5	<ul style="list-style-type: none"> - Strategjia për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike 2016-2020 - Strategjia e Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike 2015-2019 - Strategjia Kombëtare për Prokurimin Publik 2017-2021 - Strategjia për Zhvillimin e Partneriteteve Publike-Private 2014-2016 - Politikat Strategjike të Shërbimit Postar 2013-2017
9. Ministria e Zhvillimit Ekonomik	5	<ul style="list-style-type: none"> - Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës 2012-2025 - Politikat e Sektorit të Komunikimeve Elektronike - Agjenda Digjitale e Kosovës 2013-2020 - Politikat Strategjike të Shërbimit Postar 2013-2017 - Strategjia e Kosovës për TI 2014-2020 - Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës 2017-2026
10. Ministria e Punëve të Brendshme	11	<ul style="list-style-type: none"> - Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit 2013-2018 - Strategjia Kombëtare Kundër Narkotikëve të Republikës së Kosovës 2012-2017 - Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës Kundër Terrorizmit 2012-2017 - Strategjia Nacionale Kundër Trafikimit me Oenie Njerëzore 2015-2019 - Strategjia për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar 2013-2017 - Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës Kundër Krimit të Organizuar 2013-2017 - Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin e Krimit 2013-2017 - Strategjia Shtetërore për Sigurinë Kibernetike 2016-2019 - Strategjia për Zvogëlim të Rrezikut nga Fatkeqësitë 2016-2020 - Strategjia Shtetërore për Migracion 2013-2018 - Strategjia Për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta dhe Eksplozivëve 2017-2021
11. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	1	<ul style="list-style-type: none"> - Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2016

Grafikoni 1. Numri i dokumenteve strategjike për secilën ministri dhe ZKM në periudhën 2012–2017

Institucioni	Numri i Strategjive	Strategjia
12. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	1	- Strategjia Kombëtare për Trashëgimi Kulturorë 2017-2027
13. Minsitria e Shëndetësisë	1	- Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2017-2021
14. Ministria e Administratës Publike	2	- Strategjia për Modernizimin e Administratës Publike 2015-2020 - Strategjia për Trajnime të Nëpunësve Civil 2016-2020
15. Ministria e Drejtësisë	3	- Strategjia për Asistencë në Fushën e Sundimit të Ligjit 2016-2019 - Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2016-2020 - Strategjia Kombëtare për të Drejtat Pronësore në Kosovë 2016-2019
16. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	2	- Strategjia për Zhvillimin e Sektorit Privat 2013-2017 - Programi për Mbrojtjen e Konsumatorit 2016-2020
17. Ministria e Integrimi Evropiane	0	
18. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	3	- Plani Strategjik i Arsimit në Republikën e Kosovës 2017-2021 - Strategjia për Përmirësimin e Praktikës Profesionale në Kosovë 2013-2020 - Strategjia Kosovare për Rininë 2013-2017
19. Ministria e Punës dhe Mirëqenjes Sociale	3	- Draft Strategjia Sektoriale e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenjes Sociale 2009- 2013, 2014-2020 dhe 2015-2020 - Strategjia për Decentralizimin e Shërbimeve Sociale 2013-2017 - Vizioni i Kosovës për Shkathtësitë 2014-2020
20. Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë	0	
21. Ministria e Zhvillimit Rajonal	0	
22. Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës (SKSK)	1	- Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që Shpie në Terrorizëm 2015-2020
23. Zyra për Çështje të Komuniteteve (ZÇK)	1	- Strategjia për Afirmimin dhe Integrimin e Komunitetit Malazet në Kosovë
24. Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM)	3	- Strategjia Nationale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës 2013-2023 - Strategjia për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021 - Strategjia Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013-2017
25. Zyra për Planifikim Strategjik (ZPS)	2	- Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 - Strategjia për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave (IPS) 2017-2021
26. Sekretariati Koordinues (SKQ)	1	- Strategjia për Rregullim më të Mirë 2017-2021

Metodologjia

Ky hulumtim mbështetet kryesisht në të dhëna sekondare dhe fokusohet në identifikimin e të gjitha strategjive të miratuara në periudhën kohore 2012–2017 nga të gjitha ministrinë (aktualisht qeveria e Kosovës ka gjithësej 21 ministri, 5 nga të cilat nuk kanë pasur strategji në periudhën e përzgjedhur për vlerësim²) dhe Zyra e Kryeministrit. Hulumtimi ka tri pjesë kryesore. Në pjesën e parë, janë identifikuar 52 dokumente strategjike të miratuara gjatë kësaj kohe përmes hulumtimit nga zyra. D+ bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.02/2012 për Procedurat, Kriteret dhe Metodologjinë për përgatitjen dhe miratimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të tyre për zbatim ka hartuar matriksën e vlerësimit të këtyre dokumenteve strategjike e cila përmban 14 indikatorë për dokumentet strategjike dhe shtatë (7) indikatorë për Planet e Veprimit.

Në pjesën e dytë, është analizuar përmbatja e vlerësimeve apo opinioneve të Zyrës për Planifikim Strategjik për secilën nga 52 strategjitë e përzgjedhura dhe është nxjerr një pasqyrim i përgjithshëm i këtyre vlerësimeve.

Në fund është bërë hulumtim rreth angazhimit të vetë institucioneve bartëse për monitorimin dhe vlerësimin e zbatueshmërisë së strategjive në praktikë. Pasi që, me përjashtim të një ministrie, institucionet tjera nuk i kanë pasur të qasshme dokumentet e monitorimit dhe vlerësimit, janë dërguar kërkesa zyrtare për qasje në dokumente publike. Të gjitha dokumentet e dërguara nga 11 ministri dhe tre (3) zyra në kuadër të ZKM, janë analizuar dhe raportohen në pjesën e tretë të këtij raporti. Ministrinë që nuk i janë përgjigjur kërkesës për qasje në dokumente publike janë: Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria për Komunitete dhe Kthim, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Ndërsa zyrat në kuadër të Zyrës së Kryeministrit që nuk i janë përgjigjur kërkesës janë: Zyra për Çështje të Komuniteteve dhe Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës.

Vlenë të theksohet se ky raport nuk vlerëson shkallën e zbatimit apo të arriturat në praktikë të këtyre strategjive. Një numër i caktuar i këtyre strategjive do të vlerësohen në këtë aspekt në raportin e radhës të D+.

2 Ministria e Integrimeve Evropiane, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Forcës së Sigurisë, Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe Ministria e Zhvillimit Rajonal. Këto dy të fundit nuk janë subjekt i hulumtimit, pasi janë themeluar në shtator 2017.

Vlerësimet Sipas Udhëzimit Administrativ 02/2012

Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2012 për Procedurat, Kriteret dhe Metodologjinë për përgatitjen dhe miratimin e dokumenteve strategjike dhe planeve për zbatim ka hyrë në fuqi në 2012 dhe ka qenë bazë për drafimin dhe vlerësimin e dokumenteve strategjike deri në vitin 2017 kur është amendamentuar³.

Vlerësimi i strategjive dhe i Planeve të Veprimit (për ato strategji që kanë Plane të Veprimit) nga D+ është bërë në bazë të respektimit të kriterëve të UA 02/2012. Indikatorët përfshijnë aspekte të përgjithshme si afatin kohor që mbulon dokumenti, si dhe elemente teknike të dokumentit siç janë hyrja, sfondi, përmbledhja ekzekutive, metodologjia; aspekte përmbajtësore siç janë objektivat strategjike, vendime konkrete, indikatorë të matshëm; dhe aspektin financiar që është mbulueshmëria financiare e aktiviteteve.

Strategjitë përcaktojnë politika afatgjata dhe si të tilla UA kërkon që të mbulojnë një periudhë së paku tre vjeçare, mirëpo sipas vlerësimit të D+ nga 52 strategji, dy prej tyre nuk e plotësojnë as këtë kusht bazik. Pak më shumë se gjysma (30 nga 52) e këtyre strategjive kanë Plan të Veprimit, dhe për më tepër vetëm 39 nga 52 strategji kanë mbulesë financiare, ndërsa më pak se gjysma (22 nga 52) kanë indikatorë specifik dhe të matshëm. Gjithashtu një numër tejet i vogël i strategjive kanë shpjegim për qasjen e rekomanduar (23 nga 52), alternativa të shqyrtuara për arritjen e objektivave (27 nga 52) dhe hapa të ardhshëm për zbatim të strategjisë (31 nga 52).

³ UA 02/2012 ka filluar të rishikohet gjatë vitit 2017 ku si rrjedhojë me datë 4 prill 2018, Qeveria e Kosovës ka miratuar Udhëzimin Administrativ 07/2018 për planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike.

Tabela 1


Procedurat dhe kërkesat
e UA 02/2012 për
strategjitë

Vetëm 30 nga 52 strategji kanë Plan të Veprimit, e që në fakt UA 02/2012 nuk e obligon institucionin që të draftojë një të tillë për çdo dokument strategjik. Megjithatë kur një strategji ka plan atëherë përcaktohet një numër i kriterëve që duhet të plotësohen. Një i tillë është mbulueshmëria e një periudhe së paku tre (3) vjeçare, e që në fakt plotësohet nga 27 prej 30 planeve. Gjithashtu kriteret për indikatorë specifik dhe të matshëm dhe caktim të institucioneve udhëheqëse dhe mbështetëse për secilin aktivitet, e plotësojnë shumica e Planeve të analizuar në këtë studim. Mirëpo, aspektet si kosto për zbatimin e secilit veprim dhe kosto totale për periudhën e zbatimit tre vjeçar e plotësojnë një numër tejet i vogël i tyre (7 dhe 10 respektivisht).

**Tabela 2**

Procedurat dhe kërkesat
e UA 02/2012 për
Planet e Veprimit

Në përgjithësi, procedurat dhe kriteret e parapara me UA 02/2012 nuk plotësohen nga shumë dokumente strategjike dhe Planet e tyre të Veprimit. Megjithatë, të gjitha këto strategji pavarësisht nga respektimi ose jo i UA dhe pavarësisht opinionit të ZPS që jo gjithmonë ka qenë pozitiv, janë miratuar nga qeveria dhe shërbejnë si udhërrëfyes të punës së minsitrive dhe ZKM-së.



Vlerësimet e Zyrës për Planifikim Strategjik

Opinionet e ZPS-së janë dokumente zyrtare të cilat dalin nga Rregullorja e Punës së Qeverisë 09/2011⁴ si dhe Udhëzimi Administrativ 02/2012. Në përgjithësi, opinionet e ZPS-së bazohen në një format të rregulltë i cili aplikohet vazhdimisht në vlerësimin e strategjive të nxjerra nga institucionet dhe koncentrohet më shumë në identifikimin e të metave që këto dokumente përmbajnë. Këto opinionet kanë tre aspekte kryesore në bazë të të cilave bëhet vlerësimi i strategjive të hartuara nga ministrinë, zyra e kryeministrit, dhe agjensionet e pavarura:

- 1) vlerësimin e përgjithshëm, për përmbushjen e kriterëve bazë të parapara me UA 02/2012
- 2) vlerësimi në aspektin përmbajtësorë dhe ndërlidhja me prioritetet e qeverisë
- 3) rekomandim për përmirësim dhe miratim nga qeveria.

Sa i përket përmbushjes së kriterëve bazë, opinioni i ZPS-së vlerëson nëse dokumentet strategjike përmbajnë procedurat, kriteret dhe metodologjinë e përgatitjes dhe miratimit të dokumenteve strategjike, sipas UA 02/2012. Ndërsa, në aspektin përmbajtësor opinionin koncentrohet në aspekte si: saktësia dhe kualiteti i përmbajtjes, mbështetja e arsyetimit të hartimit të strategjisë në hulumtim dhe studim të gjendjes ekzistuese, përcaktimi i qartë i objektivave dhe indikatorëve të matshëm, respektimi i ndërlidhshmërisë së strategjisë me prioritetet dhe dokumente të tjera të qeverisë, koston për implementim si dhe nëse janë ndjekur apo jo procedurat e konsultimit të brendshëm dhe të jashtëm në bazë të Rregullores së Punës së Qeverisë 09/2011 dhe Rregullores për Standardet Minimale për Konsultime Publike. Aspekti i tretë, rekomandimet, zakonisht janë të vendosura në fund të dokumentit, mirëpo me raste ato mund të hasen edhe në pjesën e vlerësimit përmbajtësor ku krahas nënvizimit të mangësive ipen edhe rekomandime.

Në përgjithësi, disa nga strategjitë e ministrive dhe

Zyrave në kuadër të Zyrës së Kryeministrit nuk i plotësojnë standardet e UA 02/2012 të parapara për përgatitjen e dokumenteve strategjike. Në vijim paraqiten disa shembuj të tillë nga disa strategji të miratuara nga 2012 deri në 2017.

Megjithëse shumica dërrmuese e strategjive i plotësojnë kriteret bazë të parapara me Udhëzim Administrativ, disa nga to ZPS i vlerëson se qalojnë në aspektin përmbajtësor, duke dështuar të hartojnë objektiva të qarta dhe indikatorë të matshëm apo duke mos e bazuar nevojën për hartimin e një dokumenti strategjik në më shumë se një metodë të analizimit të situatës dhe shfrytëzimit të më shumë se një burimi të informacionit. Për dokumentin strategjik të Ministrisë së Punëve të Brendshme "Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Kufirit", ZPS gjen se nuk është hartuar plotësisht sipas UA 02/2012 dhe nuk ka objektiva të qarta dhe që ndërlidhen me Plan të Veprimt⁵. Ndërsa Ministria e Infrastrukturës në dokumentin "Strategjia e Sigurisë Rrugore", sipas opinionit të ZPS ka dështuar të hartojë objektiva të qarta duke i emëruar ato si prioritetet dhe masa, por që për ZPS-në nuk mund të konsiderohen si objektiva. Për më tepër ZPS gjen se ky dokument përveç se i ka emëruar objektivat si prioritetet ka tejkaluar edhe numrin e objektivave që një dokument strategjik, sipas UA 02/2012, mund të përmbajë⁶. Një tjetër shembull është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e cila në hartim të "Strategjisë për Mbrojtjen e Mjedisit" si vazhdimësi e strategjisë së më hershme, përsëritë një mori lëshimesh si: mungesën e mbështetjes në analiza gjithëpërfshirëse në lidhje me gjendjen e mjedisit në Kosovë, dhe nuk sigurohet për një ndërlidhje ndërmjet strategjisë së vjetër dhe asaj të re⁷. Ndërsa ndodhë edhe që disa strategji i referohen dokumenteve të cilat nuk janë aktuale, një shembull i tillë është Ministria Administratës Publike (MAP) me "Strategjinë për Trajnimin e Nënpunësve Civil".

4 Paragrafi 2 i Rregullores së Punës së Qeverisë 09/2011 përcakton se "Para dorëzimit të dokumenteve strategjike për miratim në Qeveri, organi propozues ose një trup qeveritar, që ka përgatitur materialin është përgjegjës për të siguruar nga Zyra për Planifikim Strategjik pajtimin për procedimin e dokumentit në Qeveri.

5 Zyra për Planifikim Strategjik, referencë: 001-09-2013, datë 02.09.2013

6 Zyra për Planifikim Strategjik, referencë: 003 - 09 - 2015, datë 14.09.2015

7 Zyra për Planifikim Strategjik, referencë 09.06.2013, datë 28.06.2013

Kostoja për implementimin e këtyre strategjive paraqet implikime buxhetore, dhe ky aspekt zë një vend të rëndësishëm në opinionet vlerësuese të ZPS-së. Ato koncentrohen në vlerësimin e realizueshmërisë së strategjive në aspektin financiar në afatet kohore të përcaktuara në Plan të Veprimt, përputhjen e kostos së zbatimit të strategjisë me buxhetin e qeverisë, si dhe mbulueshmërinë nga ana e qeverisë dhe, nëse parashihet, donatorëve. Ndodh që strategjitë të paraqesin kosto të pa mbulueshme financiarisht, një shembull i tillë është dokumenti “Strategjia për Decentralizimin e Shërbimeve Sociale” i cili ka një kosto të zbatimit rreth 8.5 milionë euro dhe ZPS vlerëson se nuk ka garantuar qartë nëse mund të sigurohet mbulimi i kësaj kosto. ZPS vërteton se shuma prej 2.2 milion euro është konfirmuar nga Minsitria e Financave, ndërsa për pjesën tjetër 6.3 milionë euro ZPS vlerëson se ky dokument dështon të ofrojë garanci se do të mbulohe nga donatorët⁸. Rastet si këto mund të hasen në shumë opinione të ZPS-së në lidhje me dokumente strategjike të nxjerra nga ministri apo institucione tjera, për më tepër atyre ndonjëherë iu kërkohet të kërkojnë burime të tjera të financimit⁹.

Në vlerësimet e saj, ZPS megjithëse vëren lëshime të natyrave të ndryshme apo implikime buxhetore, përsëri në fund të dokumentit i rekomandon qeverisë miratimin e strategjisë pa e kthyer tek ministria bartëse për të përmirësuar përmbajtësisht apo për të arsyetuar implikimet buxhetore. Në një rast, megjithatë, dokumentin “Strategjia Sektoriale” e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, ZPS rekomandon se nuk duhet të miratohet nga qeveria pa e harmonizuar atë me Rregulloren e Qeverisë dhe UA 02/2012 dhe pa i qartësuar format alternative të financimit të strategjisë. Ndërsa në rastin tjetër ZPS, i rekomandon qeverisë të miratojë “Strategjinë Kombëtare kundër Trafikimit me Njerëz” përkundër vlerësimin të Ministrisë së Financave se nuk është paraparë buxhet shtesë në ligjin për buxhetin të vitit 2015¹⁰ dhe rrjedhimisht implementimi i stretegjisë nuk ka mbulueshmëri buxhetore.

Në anën tjetër, MPB është institucioni me numrin më të madh të strategjive të hartuara në

periudhën 2012–2017, gjithësej 11, sipas opinioneve të ZPS-së del se kjo ministri bën më së shpeshti lëshime në hartimin e strategjive, përkundër përvojës me hartimin e dokumenteve të kësaj natyre.

Është evidente se në opinionet vlerësuese të ZPS gjendet një numër i madh lëshimesh që institucionet bëjnë në hartimin e dokumenteve strategjike duke mos arritur kështu t'i përmbahen plotësisht UA 02/2012. Aktivitetet e strategjive kanë kosto për zbatim dhe për këtë ZPS merrë për bazë vlerësimin e ndikimit financiar i cili bëhet nga Ministria e Financave dhe në të cilin theksohet se disa nga to nuk kanë mbulueshmëri financiare. Por, pavarësisht kësaj, ZPS në shumicën dërrmuese të rasteve, i rekomandon qeverisë të aprovojë strategjitë.

8 Zyra për Planifikim Strategjik, referencë: 003-12-2012, datë 28.12.2012

9 Zyra për Planifikim Strategjik, referencë: 16.09.2014, datë 03.09.2014

10 Zyra për Planifikim Strategjik, referencë: 001.05.2015, datë 07.05.2015

Si e monitorojnë Ministrinë zbatimin e Strategjive?

Ngakyhulumtim del se UA02/2012 nuke ka trajtuar mjaftueshëm dhe decidivisht monitorimin e zbatimit të strategjive, gjithashtu jo të gjitha institucionet bartëse të strategjive angazhohen për të matur nivelin e zbatimit të tyre në praktikë. Nga 16 ministri dhe pesë (5) zyra në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, të cilat kanë strategji të miratuara në periudhën e caktuar (2012-2017), 11 ministri dhe tre (3) zyra të ZKM i janë përgjigjur kërkesës për qasje në dokumente publike.

Plani i Veprimit të Strategjisë duhet të shërbejë si bazë për monitorim të implementimit të strategjisë, mirëpo nga përgjigjet e dhëna, del se praktikë e zakonshme e monitorimit të zbatimit të strategjive është që të draftohet një plan i monitorimit i cili emërtohet me emra të ndryshëm nga institucionet si Plan i Monitorimit, Pasaportë e Indikatorëve¹¹ apo Matriksë e Monitorimit dhe nga këto dokumente del raporti për progresin/regresin e zbatimit të strategjisë, zakonisht i përpiluar në fillim të vitit për vitin që lihet pas.



Në vijim paraqitet një analizë e shkurtër e dokumenteve që janë dërguar nga Minsitritë dhe zyrat e ZKM për procesin e monitorimit të strategjive të tyre.

Minsitria e Administratës Publike e vlerëson progresin e implementimit të dy strategjive që i ka miratuar gjatë periudhës 2012-2017 në baza vjetore. Për "Strategjinë për Modernizimin e Administratës Publike", është dërguar raporti vjetor për vitin 2017 i cili përmban një përmbledhje të progresit të përgjithshëm të zbatimit të strategjisë, dhe matje të progresit në aktivitete dhe në bazë të indikatorëve për secilën objektivë strategjike veç e veç. Matja e progresit është tejet e detajuar dhe konkrete, dhe secili aktivitet është i përshkruar në detaje (raporti 43 faqe). Ndërsa sa i përket "Strategjisë për Trajnime të Nëpunësve Civil", MAP harton raportin mbi vletësimin e nevojave për trajnim të nëpunësve civil për secilin institucion publik, në baza vjetore (raporti për vitin 2018, 94 faqe), por jo edhe raport për arritshmërinë e zbatimit të strategjisë në praktikë.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal gjithashtu bën vlerësime të rregullta vjetore për vitet 2016 dhe 2017, dhe gjashtë mujore për vitin 2018, për progresin në zbatimin e Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale. Si përgjigje në kërkesën e D+, MAPL ka dërguar raport për zbatimin e "Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale" ku mbulohen periudhat janar-dhjetor 2016, janar-dhjetor 2017 dhe janar-qershor 2018 (raporti 16 faqe). Në raport paraqiten aktivitetet nën përgjegjësi të Ministrisë për secilën objektivë strategjike dhe listohen të arriturat për periudhën raportuese.

Ministria e Shëndetësisë përmes Departamentit për Zhvillim Strategjik Shëndetësor ka funksionalizuar divizion të veçantë për Monitorim dhe Evaluim i cili ka mandat për monitorim të zbatimit të dokumenteve strategjike. Sipas MSH, deri në themelimin e këtij divizioni, MSH nuk ka pasur mekanizma për monitorimin dhe zbatimin e strategjive dhe Planeve të Veprimit. Në janar të 2018 është hartuar dhe aprovuar doracaku për monitorim (dokument 383 faqësh) dhe raporti i parë i zbatimit të Planit të Veprimit të "Strategjisë Sektoriale të Shëndetësisë 2017-2021" me 62 indikatorë, sipas MSH pritet të finalizohet në fund të vitit 2018 dhe synohet që në vazhdimësi të ketë raporte për zbatimin e tij.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik është një ndër dikasteret qeveritare me numrin më të madh të strategjive të miratuara në periudhën kohore 2012-2017, përkatësisht pesë (5) strategji,

11 Shënim: Pasaporta e indikatorëve është mjet ndihmës për grumbulimin e të dhënave dhe ka filluar të aplikohet në kuadër të kornizës strategjike për Reformën e Administratës Publike

i monitoron ato përmes mekanizmave të ndryshëm. Në përgjigje të kërkesës së D+ për qasje në dokumente të vlerësimit, MZHE u përgjigj se për disa strategji ka hartuar Programe për Zbatim (nuk është e qartë se cili është dallimi mes këtyre programeve dhe Planeve të Veprimit) ndërsa disa të tjerat, i vlerëson në baza periodike dhe vlerësimi del në formë të Raportit të Progresit. Në përgjigje të MZHE thuhet se dy nga pesë strategjitë kanë Programe për Zbatim: (1) “Strategjia e Energjisë 2017–2026” ka Programin për Zbatimin e Strategjisë së Energjisë 2018–2020, dhe (2) “Strategjia Minerare 2012–2025”, ka Programin për Zbatim të “Strategjisë Minerare”. Për dy strategji tjera, përkatësisht për “Strategjinë Kombëtare për TI 2014–2020” dhe Politikën e Sektorit të Komunikimeve Elektronike – “Agjenda Digjitale e Kosovës 2013–2020”, sipas MZHE janë nxjerr raport i progresit në vitin 2018 dhe 2016 respektivisht. Sa i përket dokumentit “Politikat Strategjike të Shërbimit Postar”, nuk na janë dhënë informata nëse është vlerësuar ndonjëherë niveli i zbatimit të tij. Në kërkesën tonë për qasje në dokumentet e vlerësimit, D+ ka pranuar dokumente vlerësimi për vetëm një dokument strategjik – “Strategjinë Minerare”, për të cilën është dërguar Raporti i Progresit për Programin e Zbatimit të strategjisë për çdo vit duke filluar nga 2012, e deri më 2017. Këto raporte vjetore janë tejet të detajuara dhe përfshijnë rezultate të çdo aktiviteti për secilin objektivë strategjike, përqindjen e realizimit dhe indikatorët e performancës. D+ gjithashtu ka pranuar një prezantim të formatit Power Point në gjuhën angleze për dokumentin “Agjenda Digjitale e Kosovës” të përgatitur me 22 qershor 2016 ku prezantohen informata teknike në lidhje me vetë strategjinë.

Ministria e Diasporës ka dërguar një dokument në formatin word, të titulluar “Draftraporti i vlerësimit të zbatimit të Strategjisë për Diasporën dhe Mërgatën 2013–2018” ku listohen qëllimet dhe objektivat e strategjisë dhe tregohet se ky raport është nxjerr përmes pyetësorëve dhe takimeve të drejtëpërdrejta me palët përgjegjëse për realizimin e strategjisë, duke përfshirë edhe ministrinë e linjës dhe institucione të tjera. Zbatimi i aktiviteteve matet me vlerësim të përshkallëzuar si vijon: aktiviteti është realizuar plotësisht, aktiviteti është realizuar pjesërisht, dhe aktiviteti nuk është realizuar.

Ministria e Financave është bartëse e pesë strategjive. Kryesisht, MF angazhohet për monitorimin dhe vlerësimin periodik rreth zbatimit të tyre në praktikë. “Strategjia

Kombëtare për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014–2018”, vlerësohet në baza vjetore dhe prodhon raport vjetor për çdo vit: Raporti vjetor për vitin 2014 (22 faqe), për vitin 2015 (34 faqe), për vitin 2016 (32 faqe), për vitin 2017 (32 faqe), dhe jep vlerësim për statusin e implementimit dhe rreziqet e identifikuara për secilin aktivitet. Për strategjinë për “Reformën e Menaxhimit të Financave Publike 2016–2020”, MF ka në ueb faqe të saj të publikuara: (1) Raportin vjetor të progresit të zbatimit të strategjisë së reformës së menaxhimit të financave publike 2016–2020 (31 faqe); (2) Raportin gjashtë-mujor (Janar–Qershor) 2017 për zbatimin e “Strategjisë për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike (SRMFP) të Kosovës 2016–2020” (24 faqe); dhe (3) Raportin vjetor 2017 i progresit të implementimit të strategjisë së reformës së menaxhimit të financave publike 2016–2020 (26 faqe), të gjitha këto raporte të bazuara në pasaportën e indikatorëve që ofron përshkrim të detajuar për metodologjinë e matjes së treguesëve të përfshirë në strategji (po ashtu publike në ueb të ministrisë). Për strategjinë e “Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike 2015–2019”, Planit të Veprimit i është shtuar një kolonë me titullin Monitorimi dhe zbatimi i strategjisë për KBFP 2015–2019 ku paraqiten të arriturat për secilin aktivitet. Sipas Ministrisë, disa nga aktivitetet e kësaj strategjie janë pjesë e strategjisë së MFP 2016–2020. Ndërsa për “Strategjinë për Partneritet Publiko-Privat 2014–2016”, nga Zyra e Komunikimit Publik e kësaj Minsitrie në kërkesën për dokumente të monitorimit dhe vlerësimit, na është dërguar vetëm dokumenti strategjik dhe jo ndonjë vlerësim i nivelit të zbatimit të tij. Në anën tjetër, “Strategjia Kombëtare për Prokurimin Publik 2017–2021” sipas Ministrisë zbatohet dhe monitorohet nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik dhe për monitorim dhe vlerësim të implementimit të saj duhet të kërkohej llogari nga KRPP dhe jo MF.

Ministria e Drejtësisë në përgjigjen për qasje në dokumente publike ka dërguar dy dokumente – njëri titullohet “Raporti për Implementimin e Strategjive” dhe përmban përshkrime nga një paragraf për të arriturat e dy strategjive: “Strategjia për Asistencë në Fushën e Sundimit të Ligjit dhe Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje”, ndërsa për “Strategjinë Kombëtare për të Drejtat Pronësore në Kosovë” përpos titullit nuk ka informata të tjera. Dokumenti i dytë i dërguar është një prezantim i formatit Power Point të Programit për të Drejtat

Pronësore të USAID, të titulluar “Strategjia për të Drejtat Pronësore – Një vit pas” dhe flet në gjuhën angleze për çështje të ndërmarrja në kuadër të kësaj Strategjie. Kjo lë të kuptohet që Ministria nuk ka ndonjë mekanizëm konkret për matjen konsistente të zbatueshmërisë së implementimit të tri strategjive të saj.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në periudhën 2012–2017 i ka dy strategji: (1) “Strategjia Sektoriale e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale 2014 – 2017”, dhe (2) “Strategjia për Decentralizimin e Shërbimeve Sociale 2014–2017”. E para, është strategji e cila ka vazhduar të jetë draft për shkak se nuk është aprovuar në Qeveri për arsye të implikimeve financiare. Megjithatë MPMS është mbështetur në këtë dokument në punën e saj të përditshme, dhe e ka monitoruar pjesërisht dhe jo-rregullisht zbatimin e saj në praktikë përmes mekanizmit të monitorimit (matriksa e monitorimit) të zhvilluar me ndihmën e European Training Fund. Raporti që ka dalë nga ky monitorim përmes monitorimit bazuar në matriksë, është ndarë me D+. Ndërsa e dyta, pra “Strategjia për Decentralizimin e Shërbimeve Sociale”, nuk ka pasur monitorim të rregulltë për zbatimin e saj në praktikë. Politikat e kësaj strategjie që i bien nën mandatin e MPMS, sipas ministrisë, janë bartur në Strategjinë Sektoriale që është bërë në vitin 2018 – por kjo strategji nuk është në listën e vlerësimit të D+ sepse periudha kohore të cilën ne po e mbulojmë me këtë iniciativë është 2013–2017.

Ndërsa sa i përket dokumentit “Vizioni i Kosovës për Shkathtësitë”, sipas MPMS është krijuar një mekanizëm për të monitoruar implementimin e tij. Konkretisht, Zyra Kryeministrit e ka themeluar një komision ndërministror të bashkë-kryesuar nga MPMS, MASHT, shtatë anëtarë të ministrive të linjës, dhe një anëtar nga ZPS. Komisioni ka përgatitur një raport monitorimi të quajtur “Raport i Vlerësimit” në dhjetor të 2016, ku në shtojcën e titulluar “Raporti i zbatimit të udhërrëfyesit të vizionit për shkathtësi 2020” paraqiten masat e parapara dhe përmbledhje e shkurtër e punës së kryer për secilën. Megjithatë raporti kryesisht fokusohet në evidentimin e strategjive të ndërlidhura dhe në ndërlidhjen e kësaj strategjie në proceset kombëtare të planifikimit.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit është bartëse e “Strategjisë Kombëtare për Trashëgimi Kulturor”. Në kërkesën e D+ për qasje në dokumente të monitorimit dhe vlerësimit të

zbatueshmërisë së strategjisë, MKRS na ka dërguar pesë dokumente, mirëpo asnjëra nuk është konkretisht mekanizëm apo raport i prodhur nga ndonjë mekanizëm për vlerësim periodik të implementimit të strategjisë në praktikë. Njëri nga këto dokumente është një analizë që i është bërë strategjisë në fjalë, ku analizohet se sa nga kërkesat e UA O2/2012 plotësohen nga ajo dhe sa jo. Gjithashtu na është dërguar një dokument i titulluar “Përmbledhje e takimit për prezantimin e analizës për strategjinë kombëtare për trashëgimi kulturor”. Një tjetër dokument përmban një listë të aktiviteteve që janë implementuar nën secilën objektivë por nuk e mat nivelin e implementimit duke i krahasuar ato me indikatorët e Planit të Veprimit, si dhe katër lista që përmbajnë (1) botimet e realizuara në 2017, (2) botimet e realizuara në 2018, (3) aktivitetet e programit për trashëgimi kulturor, dhe (4) Projektet përfituese sipas shpalljes publike 2017. Dy dokumentet tjera janë Plani Legjislativ për Aktet Nënligjore për vitin 2018, dhe Rregllorja për përcaktimin e institucioneve të trashëgimisë. Megjithatë asnjëri nga këto dokumente nuk jep indikacion se Ministria ka mekanizma përmes të cilëve e monitoron në baza të rregullta dhe në mënyrë sistematike se sa po implementohet “Strategjia Kombëtare për Trashëgimi Kulturor”.

Ministria e Infrastrukturës e vlerëson në mënyrë të rregulltë vjetore Strategjinë “Sektoriale të Transportit Multimodal”. Raporti është në formatin Excel dhe është i organizuar mirë, me tri kolona ku njëra i liston aktivitetet, tjetra i liston indikatorët për arritshmërinë e secilit aktivitet dhe e treta flet për nivelin e realizimit. I njëjti organizim është për nëntë (9) departamente, përkatësisht për Departamentin e Inspektoratit, atë të Automjeteve, të Infrastrukturës Rrugore, të Menaxhimit të Rrugëve, Agjensinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, Departamenti i Transportit Rrugor, Departamenti i Aviacionit Civil, Departamenti i Patentë Shoferëve, dhe Infracos. Sa i përket strategjisë për “Siguri Rrugore”, sipas MI, është përgatitur matriksa për monitorimin e masave të parapara (të zbërthyera në 12 fusha) por deri tani, nuk ka ndonjë reflektim nga institucionet e tjera përgjegjëse për realizimin e këtyre masave.

Ministritë tjera nuk i janë përgjigjur kërkesës së D+ për qasje në mekanizmat që i përdorin për monitorim dhe vlerësim të strategjive, dhe raportet përcjellëse, andaj nuk është e qartë se a ndërmarrin hapa në këtë drejtim apo jo.

Ministritë që i janë përgjigjur kërkesës së D+	Vlerësim i nivelit të implementimit të strategjive	Përgjigja e institucionit/Dokumentet e dërguara
• MINISTRIA E ADMINISTRATËS PUBLIKE		
Strategjia për Modernizimin e Administratës Publike 2015–2020	PO	Raport vjetor për 2017 për progresin e zbatimit të strategjisë (43 faqe).
Strategjia për Trajtime të Nëpunësve Civil 2016–2020	PO*	*Raport vjetor mbi vlerësimin e nevojave për trajnim të nëpunësve civil për secilin institucion publik për vitin 2018, por jo matje e nivelit të zbatimit të strategjisë (94 faqe).
• MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL		
Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016–2026	PO	Raport vjetor për vitet 2016 dhe 2017 dhe raport gjashtë mujor për vitin 2018 për të arriturat e secilit aktivitet nën përgjegjësi të MAPL (16 faqe).
• MINISTRIA E SHËNDETËSISË		
Strategjia Sektoriale për Shërbimin Shëndetësor 2017–2021	JO	Sipas MSH, pritet të bëhet në 2018.
• MINSITRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK		
Politikat Strategjike të Shërbimit Postar 2013–2017	? ¹	Nuk përmendet fare në përgjigjen e MZHE.
Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës 2012–2025	PO	Vlerësohet me Programin për Zbatim të Strategjisë Minerare – Raporte vjetore të progresit (2012–2017).
Politikat e Sektorit të Komunikimeve Elektronike – Agjenda Digjitale e Kosovës 2013–2020	?	Sipas MZHE, është nxjerr raporti i progresit në vitin 2016. Nuk është dërguar.
Strategjia e Kosovës për TI 2014–2020	?	Sipas MZHE, është nxjerr raporti i progresit në vitin 2018. Nuk është dërguar.
Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës 2017–2026	?	Sipas MZHE, vlerësohet me Programin për Zbatimin e Strategjisë së Energjisë. Nuk është dërguar.

¹*Shënim:* Në bazë të informatave që janë marrë nga Ministritë, nuk mund të vlerësohet nëse institucioni bën monitorimin e zbatimit të strategjisë/ve ose jo.

Ministritë që i janë përgjigjur kërkesës së D+	Vlerësim i nivelit të implementimit të strategjive	Përgjigja e institucionit/Dokumentet e dërguara
• MINSITRIA E DREJTËSISË		
Strategjia për Asistencë në Fushën e Sundimit të Ligjit 2016–2019	?	Janë dërguar dy paragrafe në dokument Word që flasin për çka ka shërbyer kjo strategji.
Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2016–2020	?	Janë dërguar dy paragrafe në dokument Word që përfshijnë një listë të veprimeve që MD i ka marrë në kuadër të kësaj strategjie.
Strategjia Kombëtare për të Drejtat Pronësore në Kosovë 2016–2019	?	Është dërguar një prezantim Power Point në gjuhën angleze për arritjet një vjeçare të Strategjisë.
• MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENJES SOCIALE		
Strategjia Sektoriale e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenjes Sociale 2009–2013, 2014–2020 dhe 2015–2020	Vlerësim parcial, dhe jo i rregulltë	Sipas MPMS, nuk ka qenë e aprovuar në qeveri për shkak të implikimeve buxhetore, megjithatë ka vazhduar të implementohet. Është dërguar Matrica e Monitorimit për Planin e Veprimit të Strategjisë Sektoriale 2011–2013, dokument Word (20 faqe).
Strategjia për Decentralizimin e Shërbimeve Sociale 2013–2017	JO	Sipas MPMS, nuk është krijuar ndonjë mjet për monitorim të rregullt për zbatimin e saj në praktikë, por është krijuar një Komisioni Qeveritar ne perberje prej pëfaqësuesëve të MPMS, MF, MAPL, Asociacionit të Komunave dhe Zyrës së Kryeministri që ka monitoruar zbatimin e objektivave dhe aktiviteteteve.
Vizioni i Kosovës për Shkathtësitë 2014–2020	Pjesërisht	Sipas MPMS, është krijuar një grup ndërmintoror që i vlerëson arritjet. Është dërguar "Raport i Vlerësimit" i përgatitur në dhjetor të 2016, (38 faqe).
• MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT		
Strategjia Kombëtare për Trashigimi Kulturor 2017–2027	?	Janë dërguar 5 dokumente: <ul style="list-style-type: none"> Analizë për strategjinë Përmbledhje e takimit për prezantimin e analizës për strategjinë kombëtare për trashigimi kulturor Përmbledhje e strategjisë Plani Legjislativ për Aktet Nënligjore për vitin 2018 Rregllorja për përcaktimin e institucioneve të trashigimisë Asnjëra nga këto nuk jep indikacion se MKRS angazhohet në monitorim dhe vlerësim të implementimit të strategjisë.

Ministritë që i janë përgjigjur kërkesës së D+	Vlerësim i nivelit të implementimit të strategjive	Përgjigja e institucionit/Dokumentet e dërguara
• MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR		
Strategjia për Menaxhimin e Mbeturinave 2013–2022	?	Është dërguar dokumenti strategjik, nuk jep indikacion se MMPH angazhohet në monitorim dhe vlerësim të implementimit të strategjisë.
Strategjia për Cilësinë e Ajrit 2013–2022	?	Është dërguar dokumenti strategjik, nuk jep indikacion se MMPH angazhohet në monitorim dhe vlerësim të implementimit të strategjisë.
• MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS		
Strategjia Sektoriale e Transportit Multimodal 2015–2025	PO	Raporti i zbatimit të SSTM–së për vitin 2015, 2016, 2017, në formatin Excel me tri kolona: Aktivitetet, Indikatorët dhe Realizimi, për 9 departamente veç e veç.
Strategjia e Sigurisë Rrugore 2016–2020	?	Sipas MI, është përgatitur matrica për monitorimin e masave të parapara të zbërthyer në 12 fusha. Dokument në formatin Excel por i zbrazët sepse sipas MI, deri tani nuk ka reflektim nga institucionet e tjera përgjegjëse për realizimin e këtyre masave.
• MINISTRIA E DIASPORËS DHE INVESTIMEVE STRATEGJIKE		
Strategjia për Diasporën dhe Mërgatën 2013–2018	PO	Word dokument me listë të aktiviteteve si të zbatuara plotësisht, pjesërisht apo të pa zbatuara për secilën objektive (18 faqe).
• MINISTRIA E FINANCAVE		
Strategjia Kombëtare për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo–formale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014–2018	PO	<p>Raporte vjetore të progresit të zbatimit të strategjisë për vitet si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ 2014 (22 faqe); ▪ 2015 (34 faqe); ▪ 2016 (32 faqe); dhe ▪ 2017 (32 faqe).
Strategjia për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike 2016–2020	PO	<p>Raporte vjetore të progresit të zbatimit të strategjisë (bazuar në pasaportën e indikatorëve) si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Raporti vjetor 2016 (31 faqe) ▪ Raporti 6 muhor 2017 (24 faqe); dhe ▪ Raporti vjetor 2017 (26 faqe).
Strategjia e Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike 2015–2019	PO	Planit të Veprimit i është shtuar një kolonë me titullin Monitorimi dhe zbatimi i strategjisë, paraqiten të arriturat për secilin aktivitet.
Strategjia Kombëtare për Prokurimin Publik 2017–2021	?	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik është institucioni përgjegjës për monitorim dhe raportim të zbatimit, ministria nuk ka dhënë informacion.
Strategjia për Zhvillimin e Partneriteteve Publike–Private 2014–2016	?	Kanë dërguar dokumentin strategjik, nuk kanë treguar a monitorohet zbatimi i tij.

Sa i përket zyrave në Kuadër të Zyrës së Kryeministrit: Zyra për Qeverisje të Mirë, Zyra për Planifikim Strategjik dhe Sekretariati Koordinues janë përgjigjur në kërkesën e D+ për qasje në dokumente të monitorimit dhe vlerësimit të strategjive të tyre.

Sekretariati Koordinues i Qeverisë për "Strategjinë për Rregullim më të Mirë" e ka të zhvilluar metodologjinë e monitorimit të zbatimit nga e cila nxjerr raporte vjetore për progresin e implementimit të strategjisë. Vlerësimi bëhet me anë të dokumentit "Pasaporta e Treguesit për Matjen e Treguesve të Strategjisë për Rregullim më të Mirë" i cili ofron përshkrim metodologjik për matjen e çdo treguesi në nivel të objektivave specifike të strategjisë. Ndërsa raporti vjetor përshkruan në narrativ të arriturat dhe ngecjet e secilit aktivitet në bazë të objektivave, dhe përmban tabelën e Planit të Veprimit me kolonën ku shkruhet niveli i zbatimit për secilin aktivitet.

Zyra për Planifikim Strategjik ka dërguar raportin vjetor për progresin e zbatimit të "Strategjisë për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave (IPS)", për dy vitet e fundit, 2016 dhe 2017. Këto raporte përmbajnë tabela që listojnë treguesit, progresin e arritur, atë të synuar dhe statusin, për secilën objektiv specifik. Raportet gjithashtu përmbajnë paraqitje vizuale të progresit të përgjithshëm të zbatimit të strategjisë me klasifikimin e aktiviteteve si "plotësisht të zbatuara", "pjesërisht të zbatuara" dhe "të pa zbatuara" dhe progresin e zbatimit të secilit objektiv strategjik, në të njëjtën mënyrë, të përcjellur me përshkrim të detajuar narrativ. Ndërsa për "Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016–2021", ZPS është në përgatitje të raportit të parë të vlerësimit të zbatueshmërisë, pra për dy vitet e para nuk ka ndonjë raport të monitorimit të zbatimit.

Zyra për Qeverisje të Mirë është bartëse e tri strategjive dhe nxjerr raporte vjetore të progresit të zbatimit për të gjitha strategjitë. Konkretisht, si përgjigje në kërkesën e D+ është dërguar raporti për zbatimin e "Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas në Shoqërinë Kosovare" për vitin 2017, që përmban informata të detajuara për nivelin e zbatimit të strategjisë sipas sektorëve, përmban gjithashtu edhe një analizë të sfidave dhe rekomandimeve për secilin sektor. Gjithashtu,

përfshihet raport mbi buxhetin e alokuar dhe shpenzuar për vitin 2017 të ndarë sipas sektorëve që i mbulon strategjia.

Sa i përket "Strategjisë për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara", ZQM ka dërguar dy raporte të progresit – njëri që mbulon periudhën 2013–2014 (83 faqe) dhe tjetri për vitin 2015 (50 faqe), ndërsa për vitet 2016 dhe 2017 nuk janë dërguar raporte. Raportet paraqesin tabelën e raportimit që është në fakt plani i veprimit me aktivitetet e listuara nën çdo objektivë strategjike të cilit i është shtuar një kolonë ku raportohet për zbatimin ose jo të secilit aktivitet. Pasi që zbatimi i kësaj strategjie kërkon angazhim të shumë institucioneve, në raport ceket që të dhënat janë mbledhur përmes "mekanizmit institucional për monitorim, raportim dhe zbatim" – matriksa e raportimit është përcjell tek institucionet bartëse të aktiviteteve të caktura të Planit të Veprimit, dhe të dhënat janë grumbulluar dhe raportuar nga ZQM.

Për Strategjinë për "Bashkëpunim me Shoqërinë Civile" D+ i është dërguar matriksa e monitorimit për vitin 2015 me raportin e monitorimit për të njëjtin vit (23 faqe), matriksa e monitorimit për vitin 2016 me raportin e monitorimit për të njëjtin vit (19 faqe), si dhe vlerësimi final i implementimit të strategjisë i bërë në vitin 2018 për tërë periudhën e mbuluar nga strategjia (32 faqe).

Zyra e Kryeministrit	Monitorim dhe vlerësim i zbatimit të strategjive	Përgjigja e institucionit/Dokumentet e dërguara
• ZYRA PËR QEVERISJE TË MIRË		
Strategjia Nationale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023	PO	<ul style="list-style-type: none"> Raport i progresit për vitin 2013-2014 (83 faqe) dhe për vitin 2015 (50 faqe).
Strategjia për Përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017-2021	PO	<ul style="list-style-type: none"> Dërguar raporti për zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas në shoqërinë kosovare për vitin 2017 (79 faqe).
Strategjia Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013-2017	PO	<ul style="list-style-type: none"> Raporti i vlerësimit i zbatimit për vitin 2015 and 2016 me matricat e vlerësimit, dhe vlerësimi i përgjithshëm i strategjisë i përgatitur në vitin 2018.
• SEKRETARIATI KOORDINUES		
Strategjia për Rregullim më të Mirë 2017-2021	PO	<ul style="list-style-type: none"> Pasaporta e treguesit për matjen e treguesve të strategjisë dhe Raporti vjetor narrativ për progresin e zbatimit të strategjisë për 2017, (33 faqe).
• ZYRA PËR PLANIFIKIM STRATEGJIK		
Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021	JO	<ul style="list-style-type: none"> Raporti i parë është në proces të përgatitjes.
Strategjia për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave (IPS) 2017-2021	PO	<ul style="list-style-type: none"> Raporti vjetor i progresit të zbatimit të strategjisë për vitin 2016, (30 faqe). Raporti vjetor për vitin 2017, (28 faqe).

Ndërsa Zyra për Çështjetë të Komuniteteve bartëse e "Strategjisë për Afirmimin dhe Integrimin e Komunitetit Malazez në Kosovë" dhe Sekretariati Këshillues i Sigurisë së Kosovës bartës i "Strategjisë për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që Shpie në Terrorizëm" nuk i janë përgjigjur kërkesës për qasje në dokumente publike, prandaj nuk dihet se a angazhohen në monitorim dhe vlerësim të këtyre strategjive apo jo.

Pavarësisht faktit se UA 02/2012 paraqet përgjegjësinë e institucioneve bartëse për

monitorim dhe vlerësim përgjatë implementimit, ky vlerësim bëhet nga një numër i limituar i minsitrive dhe zyrave të ZKM. Në mungesë të një mekanizmi të qartë të mbledhjes dhe shqyrtimit të këtyre raporteve të vlerësimit krijohet hapësira për papërgjegjësi nga ana e institucioneve bartëse të strategjive për vlerësim sistematik të nivelit të implementimit të strategjive në praktikë. Rrjedhimisht mungon pasqyrimi se ku qëndon një strategji në implementim nga viti në vit dhe nuk krijohet mundësia për rishikim të drejtimit të politikave dhe identifikim të arsyeve për ngecje eventuale në implementim të aktiviteteve të parapara.

Rekomandime

Zyra për Planifikim Strategjik duhet të zhvillojë kapacitetet e saj për vlerësim të cilësisë së dokumenteve strategjike nga pikëpamja e kriterëve dhe procedurave të hartimit si dhe të përmbajtjes dhe ndërlidhshmërisë me politikat tjera horizontale;

ZPS duhet të unifikojnë përmbajtjen e opinioneve të vlerësimit dhe kriterëve teknike në bazë të të cilave vlerësohen draft strategjitë;

ZPS duhet të ketë kompetenca për kthimin prapa të draft strategjive tek institucioni draftues, deri në arritjen e një drafti që i plotëson plotësisht kushtet e Udhëzimit Administrativ për kriteret dhe metodologjinë e përgatitjes së dokumenteve strategjike;

ZPS në bashkëpunim me institucionet bartëse të strategjive duhet të krijojnë një mekanizëm standard për monitorim dhe vlerësim të implementimit të strategjive;

ZPS duhet të vendos mekanizma të mbledhjes së raporteve të monitorimit dhe vlerësimit dhe të përcaktojë afate kohore për dorëzim të raporteve të monitorimit;

ZPS duhet të zgjeroj kompetencat për ndërmarrjen e masave për institucionet që nuk raportojnë për monitorim dhe vlerësim të strategjive, nuk i respektojnë afatet kohore për raportim, apo nuk i përmbushin standardet e përcaktuara të përmbajtjes së raporteve të monitorimit dhe vlerësimit;

ZPS duhet të vendos procedura dhe mekanizma për vlerësim të jashtëm ex-post për secilin strategji në përfundim të periudhës që e mbulon.

Institucionet duhet të kenë qasje sektoriale në iniciativat e tyre për të draftuar strategji me qëllim që të ulët numri i strategjive që draftohen dhe miratohen dhe të rritet kualiteti i këtyre dokumenteve.

Institucionet që draftojnë dokumente strategjike duhet t'i përmbahen dispozitave të Udhëzimit Administrativ, në veçanti:

- Kriteret për përmbajtjen teknike të dokumentit;
- Përgatitjen e Planit të Veprimit për të gjithë periudhën kohore që mbulohet nga strategjia;
- Parashikimin e buxhetit dhe burimit të tij për secilin aktivitet, përfshi specifikimin e donatorit dhe mënyrën e financimit në rast se pritet buxhet nga donacionet;
- Përgatitjen e një analize të thuktë dhe gjithëpërfshirëse të gjendjes ekzistuese dhe alternativës së propozuar për nevojën e hartimit të një strategjie.

Institucionet bartëse të strategjive duhet të angazhohen në monitorim dhe vlerësim të strategjive, përkatësisht:

- Të përgatitet një plan për monitorim dhe vlerësim të zbatimit të dokumenteve strategjike, për secilin dokument strategjik;
- Të krijohen grupe punuese brenda institucionit për monitorim dhe vlerësim sistematik të zbatimit të objektivave të strategjisë;
- Të koordinohet me institucionet tjera relevante për monitorim të implementimit të aktiviteteve që kërkojnë angazhimin e më shumë se një institucioni;
- Të raportohet në mënyrë periodike për arritjet dhe ngecjet në ZPS apo institucionin bartës.

Institucionet bartëse të strategjive duhet t'i bëjnë të qasshme për publikun (përmes ueb faqeve zyrtare):

- Dokumentet strategjike;
- Planet e tyre të Veprimit;
- Raportet e monitorimit dhe vlerësimit.



Demokrasi Plus (D+) është organizatë jo qeveritare që bashkon persona që besojnë fuqishëm në vlera demokratike dhe në një Kosovë me demokraci të mirëfilltë. Qëllimi kryesor i D+ është të nxisë vlera dhe praktika demokratike, si dhe politika që stimulojnë aktivizmin qytetarë.

Në kuadër të D+ funksionojnë tri programe kryesore: Programi për Qeverisje të Mirë, Programi për Sundim të Ligjit, dhe Programi për Zgjedhje dhe Parti Politike. D+ punon që të angazhoj institucionet qeveritare, qytetarët dhe mediat në përmirësimin e qeverisjes, avancim të politikave publike dhe fuqizimin e sundimit të ligjit.

Organizata jonë përqendrohet në përdorimin e teknologjisë informative për qëllimet e lartëshënuara, dhe si rezultat ka iniciuar platformat online **ndreqe.com** dhe **qeverisjatani.info** të cilat ofrojnë hapësirë për pjesëmarrje qytetare në vendimarrje dhe llogaridhënie të institucioneve qeveritare. Për më tepër, D+ është anëtare ProOpen, koalicioni i OJQ-ve, që ka për qëllim ngritjen e transparencës në prokurim publik dhe parandalimin e keqpërdorimit të parasë publike.

www.dplus-ks.org

Përkrahur nga:

